



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.10.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe programit,ndërmjet Republikës së Shqipërisë,përfaqësuar nga Ministria e Financave,e Fondit Shqipëtar të Zhvillimit dhe KFW Frankfurt AM MAIN, për financimin e Programit “Fondi i investimeve sociale IV”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Mark Frroku, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Tom Doshi, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Milbana Treska – Drejtore e Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me mbledhjen e komisionit. Pikë e parë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë dhe programit,ndërmjet Republikës së Shqipërisë,përfaqësuar nga Ministria e Financave,e Fondit Shqipëtar të Zhvillimit dhe KFW Frankfurt AM MAIN, për financimin e Programit “Fondi i investimeve sociale IV”. Të dëgjojmë znj.Treska përfaqësuese e Ministrisë së Financave për të bërë një prezantim të projektligjit.

Milbana Treska – Po bëj një prezantim për të dyja marrëveshjet që shqyrtohen sot në Komisionin tuaj. Projektligjet që kini përpara janë amendime të marrëveshjeve ekzistuese, pra nuk kemi hua të re. Objektivi i programit “Fondi i Investimeve Sociale’ është rritja e aksesit dhe përmirësimi i ndjeshëm i kushteve të jetesës së popullsisë rurale të rajoneve veriore të Shqipërisë (Qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër), duke synuar rehabilitimin, rindërtimin apo ndërtimin nga e para të sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, si dhe rehabilitimin ose rindërtimin e rrjetit rrugor rural, kurse ndryshimi i marrëveshjes së financimit të programit “Malet drejt tregut”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Agrikulturës synon miratimin e rishpërndarjes së fondeve dhe shtyrjen e afatit të përfundimit të programit dhe datës së mbylljes së huasë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit znj.Treska. Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.E hedhim ne votim projektligjin. Kush është dakord në parim? Dakord. Kundra? S’ka. Abstenim?S’ka. Miratohet në parim projektligji. Neni 1. Dakord. Neni 2. Dakord. Kush është dakord në tërësi? Të gjithë dakord. Miratohet ky projektligj në tërësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.10.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e ndryshimit të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit,ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për zhvillimin e agrikulturës,për Programin “Malet drejt tregut”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Mark Frroku, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Nard Ndoka, Silva Caka dhe Dashamir Peza.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Tom Doshi, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Milbana Treska – Drejtore e Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me projektligjin e dytë që kemi në rendin e ditës, “Për ratifikimin e ndryshimit të letërmarrëveshjes nryshuese të marrëveshjes së financimit,ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për zhvillimin e agrikulturës,për Programin “Malet drejt tregut”. Znj.Treska i prezantoi të dy projektligjet. Ka pyetje? Po z.Fino.

Bashkim Fino – Tek pasqyra e fundit, ne miratojmë gjithë këto kedi për për trainime, pajisje, dhe të gjitha këto shkojnë mbi 500 mijë lekë. Unë votoj kundër kësaj marrëveshjeje.

Vasilika Hysi – Përsëri tek tabela, çfarë janë studimet dhe sondazhet?

Fatmir Xhafaj – E hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim? Dakord. Neni 1. Miratohet. Neni 2.Miratohet. E hedhim në votim në tërësi. Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Dakord. Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet projektligji me shumicë votash.

MBLEDHJA MBYLLET